

MR. Urim TUSKU

POLITIKA E SHBA-SË NË KOSOVË

Ishte e qartë se SHBA-ja nuk mund ta braktiste interesimin e saj tradicional për të drejtat e njeriut dhe vlerat demokratike. Amerika e kishte dominuar NATO-n nën flamurin e integritetit, ndërsa Franca kishte qenë kurdoherë e gatshme të ngrinte në qiell pavarësinë e Evropës, duke i dhënë trajtë Bashkimit Evropian. Interesimi amerikan ishte që kudo të vendosej drejtësia. Këtë mesazh e jep dhe vetë presidenti Bill Klinton në një takim të nivelit të lartë të NATO-s, në janar të vitit 1994, ku ndër të tjera, ai u shpreh: "Unë u them të gjithë atyre në Evropë dhe në SHBA që thjesht do të na bënin të hiqim një vijë të re në Evropë dhe në Lindje, se nuk duhet t'i mbyllim rrugët e mundësisë për një të ardhme mundësisht të mirë për Evropën, që është demokracia kudo, një ekonomi tregu kudo, popuj që bashkëpunojnë kudo për sigurinë e përbashkët".¹⁾ Të njëjtën gjë, SHBA do të bënte dhe për Ballkanin, i cili ndodhej në qendër të Evropës. Konfliktet që e kishin shoqëruar këtë rajon herë pas here përbënin një kërcënim për Evropën pacifiste. Por vetëm SHBA kishte interesa strategjike. Dhe nuk vonoi paralajmërimi që SHBA-ja i bëri Serbisë. Administrata e Xh. Bushit (të vjetrit), e cila në përgjithësi kishte qenë pasive në Ballkan, vendosi të bënte një hap të guximshëm teksa po bëhej gati të linte pushtetin. Me 25 dhjetor të vitit 1992, diplomatët e SHBA-së e njoftuan Millosheviçin se SHBA-ja do të përgjigjej ushtarakisht nëse serbët do të fillonin një konflikt të armatosur në Kosovë²⁾.

Ishte hera e parë që SHBA-ja tregonte interesim për Ballkanin dhe konkretisht për Kosovën. Ata ishin të bindur që një krahinë e vogël e quajtur Kosovë, me një popullsi prej 2 milion banorësh me etnitet shqiptar, ishte e shtypur nga pakica serbe. Kjo kishte ndodhur pasi me ardhjen e liderit nacionalist serb S. Millosheviç ishte mohuar autonomia e kësaj krahine dhe përdorej policia për

shtypjen e çdo revolte. SHBA-ja kishte interesa për një Evropë paqësore dhe nuk do të lejonte një diktator si Millosheviçi të diskriminonte një popullsi vetëm se i përkiste etnisë joserbo-sllave. Tre javë pas ardhjes në pushtet të presidentit Klinton, më 1993, sekretari i shtetit Kristofer e theksoi sërish paralajmërimin që i kishin bërë diplomatët e mëparshëm “natën e Krishtlindjeve”³, ku i kërkonin Millosheviçit që të mbante qëndrim paqësor ndaj Kosovës, në të kundërt SHBA-ja do të ndërhynte pa hezitimin më të vogël. Kjo tregon sa e interesuar ishte administrata e re e presidentit Klinton në politikën e jashtme për të vendosur paqen, kryesisht në Ballkan, i cili ishte një rajon që vlonte nga tensioni i luftës në Bosnje dhe ziente në Kosovë. Shqiptarët po i bënë qëndrese paqësisht duke krijuar institucionet e tyre paralele. Nën udhëheqjen e Rugovës dhe të “Lidhjes Demokratike të Kosovës”-`ata ngritën me ngulm, por jo në mënyrë të dhunshme, çështjen e pavarësisë duke bërë të ekzistonin edhe zyrat që kontrolloheshin nga shqiptarët.⁴ Kosova ishte tepër e tensionuar nga kërcënimet e policisë jugosllave, por jo në luftë.

Shqiptarët kishin të njëjtat aspirata, por marrëveshja e Dejtonit nuk kishte bërë asgjë për ta. Disa bënë durim për arritjen e pavarësisë me mjete paqësore, ndërsa disa të tjerë iu kthyen rezistencës duke iu bashkuan një lëvizje të quajtur “Ushtria Çlirimtare e Kosovës” (UÇK). Në atë kohë dihej shumë pak për këtë grupim, shprehej sekretarja amerikane e shtetit Medlin Ollbrajt, përveçse kishte kryer sulme të vogla kundra serbëve në Kosovë¹.

Në janar të vitit 1998, Millosheviçi po përgatitej të kundërpërgjigjej ushtarakisht me masa energjike, duke dërguar ushtrinë në këtë krahinë. Amerika duke patur frikën e një krize tjetër pas asaj që kishte ndodhur në Bosnje, i bënte presion Millosheviçit duke i kujtuar përsëri paralajmërimin e Krishtlindjeve, i cili ishte bërë më 1992 nga diplomatët e Xh. Bushit (të vjetër). Gjithashtu, amerikanët gjatë presionit që i bënë Millosheviçit mundoheshin që të bindnin shqiptarët e moderuar, duke nxitur edhe dialogun me Beogradin, i cili kishte për qëllim, rivendosjen e autonomisë së Kosovës dhe nuk donin që UÇK-ja të gjente mbështetje në botë. Amerikanët ishin të vendosur që të mos përsëritej ajo që kishte ndodhur në Bosnje më parë dhe për këtë kërkohej ndërhyrje, sepse serbët kishin marrë një ofensivë ndaj popullsisë së pafajshme.

Nga mesi i korrikut 1998, kishte nisur përsëri agresioni serb ndaj popullsisë kosovare që kishte detyruar 300 mijë shqiptarë të Kosovës të linin shtëpitë e tyre. Amerikanët dërguan Richard Hollbrukun dhe mundoheshin që të gjenin një zgjidhje diplomatike për këtë çështje të rajonit të Ballkanit. Pas luftimeve të verës së vitit 1998, ku kishin mbetur shumë të vrarë nga pala shqiptare, SHBA-ja dërgoi përsëri Richard Hollbrukun, që të përpiqej ta bindte Millosheviçin për tërheqjen e trupave nga Kosova dhe më 13 tetor të vitit 1998, NATO-ja kërcënonte se do të sulmonte Serbinë brenda katër ditësh në qoftë se nuk respektoheshin rezolutat e Kombeve të Bashkuara⁵. Millosheviçi vazhdonte të mos e besonte se NATO-ja do të bënte gjë tjetër përveç paralajmërimeve të përsëritura. Ai kishte një besim të madh dhe të patundur tek vëllai sllav ``Rusia``. Mirëpo amerikanët kishin argumentuar që në fillim se diplomacia duhet të mbështetej tek forca. Përpjekjet e diplomacisë amerikane iu drejtuan aleatëve të NATO-s, sepse pa miratimin e tyre nuk mund të ndërmerrej një nismë në planin ushtarak. Në mbledhjen e parë që zhvilluan amerikanët me pjesëtarët e grupit të kontaktit, iu kërkuan atyre të vendosnin si fillim disa sanksione ndaj Serbisë. Në këtë mbledhje nuk u arrit ndonjë sukses, veç vendimit që kishte të bënte me hetimin gjyqësor të krimeve të luftës dhe ndalimin e vizave të udhëtimit për zyrtarët e lartë serbë.

Sekretarja amerikane e shtetit Medlin Ollbrajt trumbetonte me të madhe idenë e vendosjes së një force të NATO-s në Kosovë që do t'i shërbente edhe kosovarëve, por edhe serbëve që përbënin një pakicë etnike, e cila do ishte e një rëndësie jetike. Grupi I Kontaktit planifikoi të mbante një takim tjetër, në Bon të Gjermanisë. Rusët në këtë takim përfaqësoheshin nga ministri i jashtëm, Jevgeni Primakov, i cili e quajti Kosovën si çështje të brendshme të Serbisë dhe se sanksionet e vendosura ndaj Millosheviçit do t'i tërbonin më keq nacionalistët serb.⁶

Takimi i grupit të kontaktit, i kryesuar nga ministri i jashtëm gjerman, Klaus Kinkel nuk ra dakord për asgjë, çka e bindi sekretaren amerikane M. Ollbrajt, se ky grup nuk ishte organizmi i duhur sepse rusët nuk mund të dilnin kundër Serbisë. Franca dhe Gjermania nuk ishin kurrë të gatshëm të përballëshin me Rusinë, ndërsa italianët vendosjen e sanksioneve e shihnin si prishje e biznesit me serbët. Dhe këtë herë amerikanët kishin peshën më të madhe për

të mbajtur mbi supe, ata ishin të bindur se pa një Ballkan të qetë nuk do të kishte Evropë paqësore. Sekretares amerikane të shtetit, përveç sigurimit të aleatëve të jashtëm, i duhej një bashkëpëlqim edhe brenda qeverisë, çka nuk ishte aspak e lehtë. Administrata amerikane nuk dëshironte të merrte një konfrontim të ri që mund të kërkonte përdorimin e forcës. Si rrjedhojë, administrata ripohonte paralajmërimin e krishtlindjeve të vitit 1992. Administrata amerikane u vu në dijeni nga sekretarja e shtetit se, nëse nuk merren masa parandaluese, Kosova do të shkonte drejt një konfrontimi me përmasa të mëdha. Parandalimi mund të realizohej duke e bërë Millosheviçin të ndihej i kërcënuar dhe qëndrimi i SHBA-së në atë periudhë ishte se ``Asgjë nuk përjashtohet!``.

Në fund të pranverës së vitit 1998, Millosheviçi i shtoi sulmet me helikopter dhe dha urdhër që t'u vihej zjarri fshatrave të Kosovës. SHBA nuk iu drejtua më grupit të kontaktit, por NATO-s. Po bëhej e qartë tani se pa përdorimin e forcës nuk mund të arrihej asgjë, diplomacia amerikane mund të quhej ``e dështuar`` në përpjekjen për të zgjidhur çështjen me mënyra paqësore, nëpërmjet bisedimeve me Serbinë për të hequr dorë nga qëndrimi i saj. Millosheviçi, arrogant si gjithmonë, deklaronte se ushtria serbe nuk po vret popullsi të pafajshme, por është vënë në ndjekje të kriminelëve. Mirëpo që të vihej NATO-ja në lëvizje duhej një autorizim i marrë nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së. Kjo kishte një risk të madh për SHBA-në, sepse do t'i jepte një rast Ruisë të vendoste veton për NATO-n. Dhe dështimi i kësaj rezolute, do të thoshte një fitore e padiskutueshme për diktatorin serb Millosheviç. Qëllimi i SHBA-së ishte të arrihej një zgjidhje përmes bisedimeve, midis Millosheviçit dhe shqiptarëve, me qëllim që t'i sigurote krahinës një shkallë më të lartë vetëqeverisje. Për ta arritur këtë marrëveshje, midis serbeve dhe shqiptareve, duhej gjetur përfaqësuesi i Kosovës.

Ibrahim Rugova, i cili përfaqësonte qeverinë ``hije`` ishte personi më i përshtatshëm, pasi ai njihej si pacifist. Por nga ana tjetër, UÇK-ja që kontrollonte armët nuk do të pranonte që Rugova të hynte në bisedime edhe në emër të saj. Rugova shkoi në maj të vitit 1998 në Beograd dhe shtypi serb e shfrytëzoi më së miri këtë rast me fotografimin e Millosheviçit dhe Rugovës duke buzëqeshur dhe e botuar në një kohë kur policia serbe po plaçkiste

fshatrat shqiptare. Kjo fotografi e uli autoritetin e Rugovës para popullit.⁷ Pas këtij diskreditimi të Rugovës në sytë e opinionit kosovar, amerikanët e ftuan Rugovën në Uashington. Rugova theksoi se gjendja ishte tepër kritike në Kosovë dhe ai mund të pranonte një protektorat ndërkombëtar. Presidenti amerikan ishte i bindur se mund të arrihej një marrëveshje paqeje me Ibrahim Rugovën, por nuk ishte i sigurt për ta arritur këtë marrëveshje me fraksionin tjetër kryesor, UÇK-në, e cila udhëhiqej nga djali i ri i quajtur, Hashim Thaçi. UÇK-ja kërkonte pavarësinë dhe besonte se mund t'i bënte ballë ushtrisë serbe duke u përleshur drejtpërdrejt me të. Nga mesi i qershorit u bë e qartë se nuk mund të arrihej asnjë zgjidhje politike pa bindur UÇK-në të ulej në tavolinën e bisedimeve. Kështu diplomatët e SHBA-së filluan të takoheshin me përfaqësues të UÇK-së. Në radhët e UÇK-së, sipas sekretares amerikane të shtetit, Medlin Ollbrajt, dukej sikur nuk kishte mendime xhafersoniane dhe i bënte të qartë UÇK-së se nuk do ta shpëtonin atë nga telashet e shkaktuara nga vetë ajo.

Edhe në Rusi, për fatin e SHBA-së, ngjarjet politike kishin sjellë zëvendësimin e kryeministrit me Jevgeni Primakovin. Kjo përbente një lehtësi të madhe në zgjidhjen e kësaj çështjeje, për të pasur Rusinë si përkrahëse dhe jo si kundërshtarë, që kishte qenë deri në këto momente. Përpjekje të mëdha u bënë nga diplomatët amerikanë për të bindur aleatet në Evropë, pasi sanksionet ndaj Millosheviçit i konsideronin prishje të interesave të tyre ekonomike dhe më e prekur në këtë drejtim, ndihej Italia. Vështirësi të mëdha u hasën edhe për të bindur Rusinë. Ministri i jashtëm rus Ivanov, theksonte se do ta hidhte poshtë një rezolutë të Këshillit të Sigurimit që do të lejonte ndërmarrjen e veprimeve ushtarake nga ana e NATO-s dhe këtë, ai e justifikonte me faktin se Millosheviçi po i tërhiqte trupat nga krahina e Kosovës dhe prandaj nuk ishte e nevojshme ndërmarrja e një sulmi të tillë. Mbledhja që u mbajt nuk mund të ndryshonte qëndrimin e rusëve, por nga ana tjetër ndihmoi për t'i bindur evropianët se Këshilli i Sigurimit nuk do të merrte një veprim përfundimtar. Nëse kombet donin të parandalonin një luftë në Kosovë, duhet të vepronin siç ishin paraqitur kushtet. Pas kësaj mbledhjeje, që ishte mbajtur pa ndonjë rezultat të madh, SHBA-ja dërgoi përsëri përfaqësuesin e tyre në Beograd R. Hollbruk, por këtë radhë ndryshe nga e para, sepse

ky person kishte një autoritet të madh. SHBA siguroi mbështetjen e aleatëve të NATO-s dhe pikërisht ishin francezet, që deklaruan se do të mbështetnin veprimet e NATO-s mbi baza humanitare, pavarësisht nga parapëlqimet. E njëjta gjë ndodhi edhe me Gjermaninë, sepse kancelari G. Shreder i premtoi presidentit B. Clinton se do të ishte plotësisht në krah të SHBA-së. Edhe italianët ishin bashkuar me SHBA-në, edhe pse kishin disa rezerva ndaj saj. Pasi arritën mbështetjen që kërkonin nga vendet evropiane, më 13 tetor, NATO-ja i dha ultimatumin e parë Millosheviçit: Katër ditë kohë për pranimin ose jo, të kushteve për tërheqje të trupave nga krahina e Kosovës.

I dërguari amerikan atje, R. Hollbruk deklaroi se ai dhe Millosheviçi kishin arritur një marrëveshje, në bazë të së cilës Millosheviçi kërkonte 10 ditë kohë për tërheqjen e trupave. Refugjatët dhe të shpërngulurit do të lejoheshin të ktheheshin. Në Kosovë do të vendoseshin dy mijë vëzhgues ndërkombëtar, të cilët do të ishin në mbrojtjen e OKB-së. NATO-ja e fiton këtë të drejtë për të fluturuar mbi Kosovë dhe për të verifikuar aksionet serbe.``- Millosheviçi ishte një gënjeshtar i lindur``, zotimet e tij mund të mos i mbante dhe ashtu bëri.⁸ Marrëveshja theksoi edhe një herë se, fati i Kosovës ishte një problem ndërkombëtar që përcaktoi një varg detyrimesh zyrtare, të cilat Millosheviçi i kishte pranuar dhe për të cilat tani mund të kërkojë llogari. SHBA-ja e kishte ngritur problemin në arenën ndërkombëtare dhe kishin siguruar aleatë nga vendet e Evropës për vendosjen e paqes në Ballkan. Ndryshe nga ç'kishte ndodhur më parë në Bosnje, ku vitet e gjata të luftës ia kishin dobësuar vullnetin palëve për luftë, ekstremistët jugosllavë dhe ata shqiptarë ishin të freskët dhe të gatshëm për luftë. UÇK-ja po shtonte radhët e saj, duke rekrutuar të rinj dhe duke marrë armë nga Shqipëria. Ky ishte një problem i madh për SHBA-në, pasi palët ndërluftuese ishin shumë larg një kompromisi të mundshëm. Njoftimet që vinin nga i dërguari i SHBA-së në Kosovë, Uilliam Ualker, ishin tepër rrëqethëse, pasi vinin njoftime për fshatra të djegur dhe një numër të madh viktimash civile të pafajshme. Këto ishin raporte që vinin nga Uashingtoni. Sekretarja amerikane e shtetit kishte propozuar një zgjidhje. Në fillim të mbahej një konferencë si ajo e Dejtonit për Bosnjën, ku të dyja palët do të dërgonin përfaqësuesit e tyre. Bisedimit e kësaj mbledhjeje do të

kryesoheshin nga sekretarja amerikane e shtetit dhe ambasadori i SHBA-së në Jugosllavi Kristofer Hill. Plani ishte që Kosova të mbej brenda Jugosllavisë, të krijonte një polici të re dhe institucione të tjera vetëqeverisëse, pa ia mbyllur dyert pavarësisë që mund të vinte më vonë. Kjo ishte disi e vështirë për SHBA-në për t'i ulur të dyja palët në bisedime: E para, sepse Millosheviçit nuk mund t'i zihej besë dhe e dyta, UÇK-ja po forcohej dhe po tregonte mungesë dëshire për lëshime. Shqiptarët ishin të përçarë: disa përkrahnin UÇK-në dhe ishin pro luftës, të tjerët ishin për zgjidhje paqësore dhe shpresat i kishin tek SHBA dhe Evropa Perëndimore. Dhuna u shfaq sërish në pranverë të vitit 1999. "Nuk duhet pritur më!", theksonte sekretarja amerikane e shtetit, Medllin Ollbrajt, "duhet biseduar me aleatët dhe duhet theksuar se problemi qëndron tek Millosheviçi".⁹

Masakra e Raçakut ishte tepër e llahtarshme, aty pati me dhjetëra trupa të pajetë. Kjo masakër u transmetua në disa kanale televizive, që rrëqethen botën dhe sensibilizuan opinionin ndërkombëtar për atë që po ndodhte në Ballkan. Në fund të shekullit XX, në qendër të Evropës, i dërguari i SHBA-së Uilliam Ualker, i pyetur se kush ishte përgjegjës për këtë masakër nuk ngurroi të përgjigjej me një fjalë të vetme: "Policia serbe".

SHBA u bind përfundimisht se pa përdorimin e forcës nuk do të kishte asnjëherë zgjidhje. Dhe për këtë i kërkuan komandantit të përgjithshëm të NATO-s, Uesli Klark që të paralajmëronte Millosheviçin për të mos ndërmarrë shkelje të tjera të këtij lloji dhe Gjykata e Krimeve të Luftës të lejohej të hetonte ngjarjen e Raçakut. T'i kujtonin atij se kërcënimi i NATO-s qëndron ende në fuqi dhe se shqiptarët meritonin më shumë. Sekretarja amerikane e shtetit Medlin Ollbrajt thërret në një takim ministrat e jashtëm të vendeve të NATO-s dhe u kërkon që Aleanca të rishikojë planet për goditjet ushtarake. Po qe se plani i SHBA-së do të zbatohet, tri ishin përfitimet nga ky veprim:

1- Dalja e ngjarjes në plan të parë në shkallë ndërkombëtare, gjë e cila do të bënte që të dyja palët të pranonin një zgjidhje, ku përfundimi për kosovarët do të ishte vetëqeverisja dhe siguria, të garantuara nga një trupë paqeruajtëse nën udhëheqjen e NATO-s.

2- Nëse serbët do të thoshin "jo" dhe shqiptarët "po", zgjidhja do të paraprihej nga një periudhë bombardimesh. Kongresi amerikan

ishte më tepër për krijimin e një ekipi verifikues sesa për praninë e trupave të armatosura, ndryshe nga presidenti Bill Clinton, që e theksonte me të madhe se duhej ndërhyrë për të shmangur gjakderdhjen e njerëzve të pafajshëm.

3- Pa mbrojtjen e NATO-s, gueriljet nuk do të çarmatoseshin kurrë dhe pa pjesëmarrjen amerikane nuk do të kishte mbrojtje nga ana e NATO-s, sadoqë ajo ishte e papranishme. Por edhe pa qenë ndërhyrja e NATO-s, Millosheviçi do të vazhdonte sulmet.

Gjatë takimeve të nivelit të lartë që zhvillonte sekretarja amerikane e shtetit, Medlin Ollbrajt, argumentet e saj filluan të fitojnë terren. Për ironi, Millosheviçi këmbëngulte para gjeneralëve, Uesli Klark dhe Neuman, se njerëzit që ishin vrarë në Raçak kishin qenë të gjithë terroristët. Dhe kur Klarku i kishte përmendur mundësinë e goditjeve ajrore të NATO-s, Millosheviçi e kishte quajtur atë ``kriminel lufte``. SHBA-ja shpresonte që përveç përdorimit të forcës, të zbatonin edhe rrugën e dialogut, duke i ulur të dyja palët në bisedime. Për planin sesi do të arrihej ky projekt, u hodh ideja të bëhej një mbledhje e grupit të kontaktit, mirëpo duhej parashikuar edhe presioni që do të bënte Rusia si anëtare e këtij grupi. Kryediplomatja amerikane, Medlin Ollbrajt u takua me homologun e saj rus, Igor Ivanov dhe të dy ishin në një mendje për zgjidhje politike, por nuk ishin të njëjtin mendim për rrugët që do të ndiqnin për të arritur tek zgjidhja. Rusia ishte kundër përdorimit të forcës ndaj vëllezërve të tyre sllavë.¹⁰ SHBA i bën presion të qartë Ruisë se nëse Kosova do të shpërthente, bashkëpunimi edhe për një numër çështjesh të tjera do të ndërpritej. Për herë të parë, u ra dakord me grupin e kontaktit që ishte mbledhur në Londër, më 29 janar 1999, se bisedimet për paqen mund të fillonin në Rambuje, më 6 shkurt 1999. Të dyja palëve do t'u kërkohej të pranonin një plan, sipas të cilit popullit të Kosovës do t'i njihej autonomia dhe se ky plan do të zbatohet nëpërmjet një force paqeruajtëse të NATO-s.

Statusi i Kosovës do të rishqyrtohej pas tre vjetësh ku mes faktorëve të tjerë që do të merreshin parasysh, do të ishte edhe vullneti i popullit. Me shpalljen e planit ishte bashkuar dhe pala ruse, që përfaqësohej nga ministri i jashtëm Ivanov. Rambujeja, u zgjodh si vendi ku do të mblidheshin përfaqësuesit për të diskutuar. Ndërtesa ku do të zhvilloheshin bisedimet ishte një kë-

shtjellë e shek. XIV. Ndonëse ministri i jashtëm i Britanisë, Robin Kuk dhe ai francez, Hubert Vedrin ishin organizatorët kryesorë, bashkërendoheshin edhe nga trojka e përbërë nga ambasadori i SHBA-së në Jugosllavi, Kristofer Hill, ambasadori i BE-së, Volfang Petric dhe ambasadori rus, Majorski. Delegacioni kosovar përbëhej nga 16 persona duke përfshirë të gjithë spektrin politik, siç ishin përfaqësuesit e UÇK-së, të LDK-së dhe Lëvizjes së Bashkuar Demokratike. Delegatet kosovarë zgjodhën edhe kryetarin e tyre, i cili ishte Hashim Thaçi, zgjedhja e tij në postin e kryetarit tregonte rënien e vazhdueshme të autoritetit të Rugovës. Ndera delegacioni serb përbëhej nga një numër juristësh që gëzonin respekt. Në këtë takim shkon dhe vetë sekretarja amerikane M.Ollbrajt, e cila shprehet: "Kjo ishte një pikë e rëndësishme sepse jemi në udhëkryq vendimtar, një zgjidhje e mundshme ose vazhdimi i dhunës dhe i kaosit". Ajo u bëri të qartë palës shqiptare se, rruga e marrëveshjes u sjell mundësinë që të vendosin vetë të kenë gjuhën dhe kulturën shqiptare dhe kjo do bëjë që t'i kthehen jetës normale.¹¹ Ajo foli edhe për tri përfundimet: E para, n.q.s. serbët tërhiqen, NATO-ja nuk do të përdorë forcën.

E dyta, n.q.s. shqiptarët tërhiqen, do ta humbin mbështetjen e SHBA-së. "Do të marrim masa që të mos merrni ndihmë prej tjetërkujt. SHBA-ja, ka vendosur që të arrihet marrëveshja të marrin pjesë në një forcë ndërkombëtare që do të çohet atje". Duke vijuar më tej, sekretarja amerikane tha, "Mesazhi jonë është i qartë: Ose luftoni vetë, ose arrini paqe me Amerikën në krah!".

Ky ishte mesazhi që SHBA-ja i jepte delegacionit të Kosovës që të nënshkruante marrëveshje me palën serbe, në të kundërt do të ngeleshin pa aleat të jashtëm dhe do të përballëshin të vetëm në luftë, derisa të shkatërroheshin nga forcat serbe. Pas kësaj, Ollbrajt kërkoi një takim me të dyja palët e armiqësuar dhe theksoi se plani që kishin përpara ishte i qartë, si një dokument për ardhmërinë. Ollbrajt shprehu edhe keqardhjen e saj për njerëzit që ishin përfshirë në luftë. "Popujt tuaj, u shpreh ajo, meritojnë fat më të mirë, prania e NATO-s është e rëndësishme, roli i saj është stabilizues"¹².

SHBA vazhdonte t'i bënte presion udhëheqjes serbe dhe pikërisht presidentit të Serbisë, Milan Milutinovic, në një takim me sekretaren amerikane. Ai pranoi se Beogradi kishte bërë gabim, duke i

mohuar autonominë Kosovës. Në Rambuje ndodhte ndryshe, palët ende nuk po binin dakord për nënshkrimin e kësaj marrëveshje, sepse nuk kishin besim te SHBA, nëse do të merrte me të vërtetë pjesë në një forcë ndërkombëtare për të ndërtuar paqen. Të gjithë pjesëtarët e delegacionit kosovar ishin në një mendje për mbajtjen e një referendumi rreth çështjes se pavarësisë. Gjermania ishte dakord për planet e propozuara nga SHBA-ja

dhe kështu nëpërmjet ministrit të saj të jashtëm, Joshka Fisher, u shpreh se e mbështeste plotësisht planin për dërgimin e trupave të NATO-s në Kosovë. "Bashkimi Evropian, theksoi ai, nuk e përkrah pavarësinë e Kosovës. "E dimë se shqiptarët vuajnë dhe nuk mund të pajtohem me masakrat dhe katastrofën humanitare".¹³ Ditët në Rambujes kalonin, delegacionet ishin akoma në mëdyshje për nënshkrimin e marrëveshjes. Kur papritmas merret vesh se Millosheviçi ka refuzuar kërkesën e ambasadorit Hill për vendosjen e trupave të NATO-s. SHBA-ja ishte e vendosur për dërgimin e trupave dhe askush nuk mund ta ndalte. Ambasadori Hill theksoi se nuk mund të ketë zgjidhje pa mekanizmin implementues të NATO-s dhe s'mund të ketë NATO pa SHBA-në. Dhe në këtë rast SHBA-ja nganjëherë duhet të veprojë vetë e pa bashkëpunëtorë të tjerë dhe pas kundërshtimit të Millosheviçit për dërgimin e trupave të NATO-s, SHBA-së nuk i mbetej gjë tjetër vetëm të vepronte. I të njëjtit mendim për të qëlluar mbi Serbinë ishte dhe këshilltari për Sigurimin Kombëtar të SHBA-së, Sandi Berger. Vetë orvatja e Rambujesë shprehte vullnetin e Francës e të Britanisë së Madhe për ta kthyer Kosovën në një testim, për të administruar një krizë në kufijtë e Bashkimit Evropian.¹⁴ Por ndryshe nga këto vende, SHBA-ja ka inkurajuar aspiratat e kosovarëve, për të arritur krijimin e një vetëqeverisje, por me mjete paqësore, duke ndërhyrë faktori ndërkombëtar.

SHBA-ja po haste pengesa edhe tek delegacioni kosovar, i cili nuk kishte besim të madh te nënshkrimi i kësaj marrëveshje, që do të sillte fundin e luftës dhe një lloj autonomie për Kosovën. Ambasadori amerikan Hill, u shpreh: "Duke iu drejtuar delegacionit kosovar, ju keni dëshiruar udhëheqjen tonë, që trupat tona t'ju ndihmojnë në implementimin e marrëveshjes, që forcat tona t'ju ndihmojnë për tërheqjen e trupave serbe nga Kosova, vetë kryetari ynë ka folur për Kosovën."

Me këtë rast presidenti i SHBA-së u interesua vetë drejtpërdrejt për atë që po ndodhte në Kosovë. Edhe një herë ambasadori Hill përsëriti që na nevojitet ndihma juaj që të japim ndihmën tonë.¹⁵ Më pas ndërhyjnë edhe sekretarja amerikane, ku e rithekson edhe njëherë, që shqiptarët të pranojnë marrëveshjen, pasi është shansi i fundit që iu jepet, përndryshe SHBA-ja do të largohet prej tyre. Amerika, theksoi ajo, duhet të gjejë mënyrën praktike për t'ju ndihmuar, jemi përpara një momenti tepër të vështirë, pasi një "jo" e marrëveshjes, do të thotë vdekje të mëtejshme për popullin tuaj. Ndërsa me nënshkrimin e marrëveshjes nuk do të humbni, por do të fitoni paqen dhe trupat amerikane në tokën e Kosovës. Këtu shpjegohet sa të vështirë e kishin amerikanët për të bindur UÇK-në të ulte armët dhe t'i drejtohej tavolinës së bisedimeve. Bisedimet kishin ngelur tek çështja e referendumit. SHBA-ja po haste me të vërtetë vështirësi të mëdha dhe zonja Ollbrajt përmend edhe Radikalet në radhët e delegacionit shqiptar.

"Të pranosh referendumin, thotë sekretarja, është të pranosh Pavarësinë e Kosovës e kjo s' bëhet as nga SHBA-ja, as nga Bashkësia Ndërkombëtare. "Mos harroni!- ju drejtohet Medlin Ollbrajt delegacionit kosovar, se sekretarja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës po merret katër orë me një popull dy milionësh." Ishte e pamundur t'i mbushje mendjen udhëheqësit politik të UÇK-së Hashim Thaçit. Këtu ndërhyri dhe ministri i jashtëm Italian, Lamberto Dini, i cili gjithnjë kishte mbajtur qëndrim kritik ndaj UÇK-së. Ai theksoi se Thaçi jo vetëm duhet ta pranonte marrëveshjen-kornizë, por edhe të hiqte dorë nga referendumi për pavarësi.¹⁶ Hashim Thaçi ishte si i vënë në morsetë sepse ndodhej ndërmjet dy zjarreve, nga njëra anë ishin perëndimorët që bënin presion, nga ana tjetër ishin bashkëluftëtarët e tij që i kërkonin të mos e "shiste" Kosovën.

BIBLIOGRAFIA:

1. Bill Clinton, "Jeta ime", Tiranë, 2005.
2. Bill Clinton, "Ne luftën, ju paqen", Tiranë, 2000.
3. Bernard Kushner "Luftëtarët e paqes", Tiranë, 2004.
4. Henry Kissinger, "Diplomacia", Tiranë, 1999.
5. Jens Reuter, "Shqiptarët në Jugosllavi", Tiranë, 1999.